



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:089041

Datë: 14.10.2024

Numri i dokumentit: 06292901

KPPP.nr. 1349/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Banka Credins” Sh.A., me NIPT K316088010 dhe me seli në Rr. “Vaso Vasha”, nr. 8, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Editon Osmani, avokat nga Prishtina, kundër debitorëve; 1. Shoqëria Tregtare “ABB Energy” Sh.P.K., me numër të biznesit 70291252 dhe seli në Fushë Kosovë; 2. A.G., me numër personal ... dhe adresë në Prishtinë, dhe; 3. B.T.G., me numër personal dhe adresë në Prishtinë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve RPHS LaË, me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorëve të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 243/21, të lejuar me datë 06.04.2021, nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha, me seli në Prishtinë, me datë 14.10.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorëve 1. Shoqëria Tregtare “ABB Energy” Sh.P.K., me numër të biznesit 70291252 dhe seli në Fushë Kosovë; 2. A.G., me adresë në Prishtinë, dhe; 3. B.T.G. me adresë në Prishtinë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 243/21, të lejuar me datë 06.04.2021, nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 243/21, të lejuar me datë 06.04.2021, nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Banka Credins” Sh.A., mbi bazën e dokumentit përmbarimor, Kontratës mbi Hipotekën LRP.nr. 1184/2015 dhe Kontratës mbi Hipotekën LRP.nr. 1189/2015, e datës 18.02.2015, për sigurimin e kërkesave nga Kontrata e kredisë Nr. 5316, e datës 11.02.2015, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 243/21, të datës 06.04.2021, për realizimin e borxhit ndaj debitorëve në vlerë prej EUR 207,991.70.

Debitorët, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor kanë ushtruar prapësim me të cilin e kanë kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetim se debitorët dhe kreditori kanë lidhur Kontratë Huaje Nr. 5316, me datë 12.02.2015, ndërsa në kuadër të Kontratës së Huasë si kontratë kryesore, debitorët dhe kreditori kanë lidhur Kontratë Siguruese Nr. 1429, me datë 12.02.2015, të cilat janë lidhur pranë zyrës së noterit në Shqipëri. Ndërsa, si kontratë aksesore që siguron obligimet që dalin nga Kontrata e Huasë, kanë lidhur edhe Kontratën e Hipotekës LRP.nr. 1184/2015, pranë zyrës së noterit në Kosovë. Më tej, ka theksuar se sipas dispozitave të kontratës së huasë është e përcaktuar se si gjykatë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve eventuale në mes të kredidhënësit dhe kredimarrësve të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ashtu që Përmbaresi Privat nuk ka kompetencë për të ndërmarrë veprime përmbarimore për detyrimet që dalin nga Kontrata e Huasë. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet procedurale.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim ka theksuar se debitorët nuk i janë përmbajtur detyrimeve që rrjedhin nga kontrata për kredi, respektivisht kanë dështuar që të kthejnë kredinë në kohë sipas planit të pagesave, e të cilat kontrata nuk janë kontestuar as nga debitorët në prapësimin e paraqitur. Më tej, ka theksuar se sa i përket pretendimit se Përmbaresi Privat nuk ka kompetencë të ndërmarrë veprime përmbarimore për detyrimet që dalin nga Kontrata e Huasë janë të pa bazuara, pasi që është kompetente Gjykata në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria, sipas nenit 190 të LPP-së, andaj edhe Përmbaresi Privat ka kompetencë lëndore dhe territoriale për të lejuar propozimin për përmbarim të parashtruar nga kreditori. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorëve si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore,

(tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22, pika 1.7 përcaktohet se *“kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”*. Në anën tjetër, me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata duke vlerësuar Kontratë mbi Hipotekën LRP.nr. 1184/2015, e datës 18.02.2015 dhe Kontratën mbi Hipotekën LRP.nr. 1189/2015, e datës 18.02.2015, gjeti se të njëjtat janë paraqitur në kopje të vërtetuar, janë hartuar në formën e paraparë me ligj, dhe se të njëjtat janë regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës nr. 011-954-6-117/15, të datës 19.02.2015 dhe Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës nr. 011-954-6-116/15, të datës 19.02.2015, dhe si të tilla përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22, pika 1.7, lidhur me nenin 27 të LPP-së, për të qenë dokumentet të përmbarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorëve se përmbaruesi privat në Kosovë nuk ka kompetencë për trajtimin e kësaj çështje, ngase palët në kontratën e kredisë kanë përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në Tiranë si gjykatë kompetente për trajtimin e kontesteve mes palëve, mirëpo të njëjtat i gjeti të pabazuar, pasi që në këtë procedurë objekt trajtimi është kontrata e hipotekës si dokument përmbarimor, e në të cilën palët janë njoftuar nga ana e noterit dhe janë pajtuar që e njëjta kontratë përbën titull ekzekutiv dhe se në rast të vonesave të pagesës së kredisë, kreditori mund të nisë procedurën e përmbarimor e cila mund të shpie në humbjen e pronësisë së paluajtshmërisë.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 73, paragrafi 1 dhe 3 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1349/22, datë 14.10.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.